



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Emri i Detyrës Name of Position Nazivna Duhetoria	11-03-2022	2 viti god year
Organizata Organization Organizacija	SKDNSHC	
Nr. Prot. in Prot. Prot. No.	1315/2022	
Shtojca Prilog Appendix		
Sasia Kolicina Quantity		113



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.105/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.105/2022 e datës 10.02.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: Fushë Kosovë, kundër Vendimit Nr.KDNSHC-05/001/2022 të Komisionit Disiplinor të Policisë së Kosovës të datës 02.02.2022, në çështjen juridike “Kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet **jo kompetent** për të vendosur për ankesën me numër A.nr.105/2022 të datës 10.02.2022, të parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi në bazë të shkresave të lëndës është i punësuar në Policinë e Kosovës, me gradën Kolonel në pozitën Drejtor i Drejtorisë për Hetime dhe Verifikim të së Kaluarës, ndërsa me datë 13.12.2021 me shkresë përcjellësi i është drejtuar Komisionit Disiplinor për Nëpunës të Shërbimit Civil të Policisë së Kosovës duke e informuar se me rastin e ndryshimeve ligjore, për rastet e trajtimit të lëndëve të stafit civil të cilat kanë qenë në trajtim e sipër paraprakisht nga Drejtoria për Hetime dhe Verifikim të së Kaluarës, tani kompetent është Komisioni Disiplinor, dosje të cilat janë përcjellë paraprakisht në fund të vitit 2020 në Sekretarin e Komisionit Disiplinor me qëllim të shqyrtimit të tyre.

Komisionit Disiplinor për nëpunës të Shërbimit Civil të Policisë së Kosovës, me datë 02.02.2022 nxjerr vendimin numër: Nr.KDNSHC-05/001/2022 duke e shpallur veten jo kompetent dhe njëherit ankuesit i jep këshillën juridike që pala e pakënaqur mund të parashtror ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës.

Ankuesi kundër Vendimit Nr.KDNSHC-05/001/2022 të Komisionit Disiplinor të Policisë së Kosovës të datës 02.02.2022, ka parashtruar ankesë më datë 10.02.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil



të Kosovës, me pretendime ankimore se vendimi i Komisionin Disiplinor është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat ligjore për Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik me kërkesën që Këshilli të anuloi vendimin e Komisionit Disiplinor dhe të përcaktoj kompetencat e organit kompetentë për hetimin dhe shqiptimin e masave disiplinore ndaj zyrtarëve të shërbimit civil në Policinë e Kosovës

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.02.2022, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Policia e Kosovës. Më datë 08.03.2022 Policia e Kosovës ka përcjell gjithë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës me numër protokolli 650/2022 e datës 10.02.2022 me shkresat e bashkangjitura 1/32; Vendimit Nr.KDNSHC-05/001/2022 të Komisionit Disiplinor të Policisë së Kosovës të datës 02.02.2022; Listën e nëpunësve civil dosjet e të cilëve janë dërguar për shqyrtim në Komisionin Disiplinor; Shkresën e datës 13.12.2021 për shqyrtimin e rasteve disiplinore; E-mailin e datës 08.02.2022 dërguar nga _____ për ankuesin; E-mailin e datës 04.02.2022 dërguar nga _____ për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 (tre) faqesh; Memorandumin e datës 05.02.2001; Udhëzimi Administrativ Nr.04/2019 për Shkeljet, Masat dhe procedurat Disiplinore në Policinë e Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 18.02.2022; Përgjigjen në kërkesa nga Policia e Kosovës e datës 08.03.2022 me numër prot:1242/2022 me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.105/2022 të datës 10.02.2022, të parashtruar nga ankuesi

sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të prova të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankuesi në bazë të deklarimeve në ankesë si dhe në bazë të shkresave të lëndës të dërguara nga Policia e Kosovës, se ankuesi është i punësuar në Policinë e Kosovës, me Gradë Kolonel në pozitën Drejtor i Drejtorisë për Hetime dhe Verifikim të së Kaluarës.

Me qëllim të vlerësimit të kompetencës për shqyrtimin e ankesës së ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik nenin 2 paragrafin 3 i cili përcakton se: *“Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë”* si dhe nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe paragrafin 3 nën paragrafin 3.3 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *“Ky ligj nuk zbatohet për: funksionarët publikë me status të veçantë. Funksionarë publikë me status të veçantë, në kuptimin e nën paragrafit 1.2 të këtij neni janë: zyrtarët policor të Kosovës dhe inspektorati policor i Kosovës”*, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil në Shërbimin Civil, ndërsa për zyrtarët policor të Kosovës nuk zbatohet Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ngase marrëdhënia e tyre e punës rregullohet tërësisht me ligj të veçantë sektorial.

Në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: Shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil”*, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat për nëpunësit civil të Shërbimit Civil dhe kandidatëve që konkurrojnë për pranim në Shërbimin Civil, të përcaktuar në nenin 2 paragrafi 3 dhe nenin 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Andaj, pas konstatimit se pozita të cilën e ushtron ankuesi nuk është pozitë e Shërbimit Civil, Kolegji konstaton se

Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit [redacted] pasi që ankuesi nuk e ka statusin e nëpunësit civil në Shërbimin Civil.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit nga Kryetari të Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.105/2022

Flakron GASHI

Zyrtare i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit*
- *Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Policinë e Kosovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së.*

